



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:029679

Datë: 26.10.2020

Numri i dokumentit: 01218951

**P.nr.1057/16**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**- Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e praktikantes juridike, Edita Ferati, në çështjen penale, kundër të pandehurit, V.Q. nga fsh. ...., K. Pejë, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale, vjedhje, parashikuar nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK- së, vjedhje, parashikuar nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK- së dhe vjedhje e rëndë, parashikuar nga neni 327 par.1 i KPRK-së, duke vendosur, sipas aktakuzës, së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, PP.II.nr.1251/2016 të datës 11.11.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datë 14.10.2020, në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit V.Q. dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. Bajram Zekaj, me datë 15.10.2020 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 16.10.2020 perpiloi:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari,**

V.Q., i biri i M. dhe nënës B., e vajzërisë G., i lindur me ..... në Peje, ndërsa tani me vendbanim në fsh. .... Rajoni .... K-Pejë, i pa pune, i martuar baba i një fëmije, ka të kryer pesë klase të shkollës fillore, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. ...., posedon tel. me nr. ...., egjiptian, Shtetas i Republikës se Kosovës, i ndaluar ne fsh. ...., K. Mitrovicë dhe i sjellë te gjyqtari me dt. 14.10.2020 ne ora 18:15.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

- Me datë 28.04.2016, rreth orës 19.00, ne fshatin ..... K-Pejë, i pandehuri V.Q. në bashkëveprim me të miturin E.S, me qëllim te përvetësimit te kundërligjshëm për vete marrin sendin e luajtshëm të personit tjetër dhe atë te dëmtuarit A. G., në atë mënyrë qe pasi që i dëmtuari ishte duke i dërguar bagëtinë për ne Stallë, gjate rrugës te pandehurit ia marrin tri dele dhe me pas te njëjtit largohen nga vendi i ngjarjes,

-Me çka ka kryer vepër penale, vjedhje, parashikuar nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK- së

- Me datë 03.05.2016, në kohë të pa caktuar, në fshatin ....., K. e Pejës, i pandehuri V.Q., me qellim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete merr sendin e luajtshëm të personit tjetër, dhe atë të dëmtuarës J. K., në atë mënyrë i pandehuri me të arritur në vendin e lartcekur hynë në oborrin e të dëmtuarës dhe hap kotecin e shpezëve dhe nga aty merr dy qura në vlerë prej 200 euro, dhe më pas i njëjti largohet nga aty pa u vërejtur nga askush,

Me çka ka kryer veprën penale, vjedhje, parashikuar nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

- Me datë 14.05.2016, rreth orës 11:00, në fshatin ..... K-Pejë, i pandehuri V.Q., me qellim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete marrin sendin e luajtshëm të personit tjetër, dhe atë të dëmtuarit B. Q., në atë mënyrë i pandehuri me të arritur në vendin e lartcekur me forcë hap derën e kotecit të pulave i cili ishte i mbyllur me dry dhe nga aty marr 10 shpezë (pula), me ngjyrë Bardhë-zi në vlerë rreth 100 euro, dhe me pas largohet nga vendi i ngjarjes pa u vërejtur nga askush,

Me çka ka kryer veprën penale, vjedhje e rëndë, parashikuar nga neni 327 par.1 i KPRK-së

Andaj, gjykata komform nenet 2, 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 21, 41, 42 par.1 pika 1.1, 43 par.1 nen par. 1.2 dhe 1.3, 45 par.1, 46, 73, 74, 75, 76, 325 par.1, 325 par.1 lidhur me nenin 31 dhe 327 par.1 të KPRK-së, dhe neneve 245,246, 248 par.1 dhe 4, 325, 359, 360, 361, 362, 363, 365, 366, 370, 453 par.4 dhe 463 par.2, të KPRK-se, të pandehurit i :

### PERCAKTON

-Për veprën penale nga pika 1 e aktakuzës/aktgjykimit, dënim gjobe në shumë prej 300 (treqind) euro.

-Për veprën penale nga pika 2 e aktakuzës/aktgjykimit, dënim gjobe në shumë prej 300 (treqind) euro.

-Për veprën penale nga pika 3 e aktakuzës/aktgjykimit, dënim me gjobe në shumë 300 (treqind) euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Pas unifikimit të dënimeve në kuptim të nenet 80 par.1 dhe 2, pika 2.2 të KPRK-së, gjykata, të pandehurin V.Q. e:

### GJYKON

- I. Dhe me dënim unik gjobe në shumën të përgjithshme prej 900 (nëntëqind) euro, e i cili dënim ka për tu ekzekutuar në afat prej 90 ditësh pasi që aktgjykimi të behet i plotfuqishëm.
- II. Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti burgim, e i cili dënim ka për tu vuajtur pasi aktgjykimi ta merr formën e prerë.
- III. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në shumën e unifikuar të cekur si më lartë në pikën I. prej 900 (nëntëqind) euro, dështon apo refuzon ta paguajë, i njëjti do t'i

zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur për një dite burgimi shumen nga 20 euro te gjobës se unifikuar.

- IV. Detyrohet i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve te procedurës penale te paguaje shumen prej 30 (tridhjetë) euro, ne emër te paushallit gjyqësor shumen prej 20 (njëzet) euro ndërsa ne emër te viktimave te krimit shumen prej 30 (tridhjetë) euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi qe aktgjykimi ta marr formën e prerë.
- V. Palët e dëmtuara, A. G., J. K. dhe B. Q. për kërkesën pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzën PP.nr.1251/2016 e dt. 11.11.2016, ka akuzuar V.Q. nga fsh. ...., K. Pejë, për dy vepra penale, **vjedhje**, parashikuar nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-së, dhe për veprën penale, **vjedhje e rëndë**, parashikuar nga neni 327 të KPRK-së duke i propozuar gjykatës qe te cakton shqyrtimin gjyqësor kundër te njëjtit, ti administroje provat e propozuara e ne fund i njëjti te shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, dhe te ngarkohet me shpenzimet e procedurës penale.

Gjykata me dt. 14.10.2020 ka caktuar dhe e ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ku ka qenë prezent Prokurori i Shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri V.Q. dhe avokati mbrojtës i caktuar sipas detyrës zyrtare av. Bajram Zekaj.

Pas njoftimit me te drejtat si i akuzuar, te pandehurit i është lexuar aktakuza PP.nr.1251/2016 e dt. 11.11.2016, ashtu qe pas leximit te aktakuzës i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprat penale qe akuzohet, e te cilin pranim fajësie, Gjykata e ka pranuar me aktvendim ne procesverbal te shqyrtimit fillestar ne baze te nenit 248 te KPRK-së.

Me këtë pranimi të fajësisë është pajtuar edhe Prokurori i Shtetit.

Me pranimin e fajësisë Gjykata ne tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer veprat penale sipas dispozitivave 1, 2 dhe 3 te aktgjykimit me dt. 28.04.2016, 03.05.2016 dhe 14.05.2016 ne kohen, vendet dhe mënyrat e përshkruara si ne dispozitivat e aktakuzës/aktgjykimit dhe atë të vjedhjes parashikuar nga neni 325 par. 1 lidhur me par.31 të KPRK-së dhe vjedhjes se rende parashikuar nga neni 327 par.1 te KPRK-së.

Gjykata paraprakisht te pandehurit i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë dhe e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjti do te shpallet fajtor për veprat penale te lartcekura, do ti shqiptohet sanksioni i parapare me ligj, dhe se nuk do te këtë administrim te provave.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që e ka bërë i pandehuri i cili ka pasur të njohur natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, në mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barë, i cili pranim mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë: raporti i policit Avdullah Mehaj me nr. të rastit 2016-DA-0913 i dt. 28.04.2016, deklarata e të dëmtuarit A. G. e dhënë në polici me datë 28.08.2016, deklarata e dëshmitarit E. Q. e dhënë në polici me datë 04.05.2016, deklarata e dëshmitarit D. H. e dhënë në polici me datë 04.05.2016, raporti i policit Hilmi Ramaj i datës 30.04.2016, deklarata e të dëmtuarit A. G. e dhënë në polici me datë 30.04.2016 si dhe në prokurori me datë 28.10.2016, deklarata e dëshmitarit A. B. e dhënë në polici me datë 30.04.2016, deklarata e dëshmitarit D. Sh. e dhënë në polici me datë 06.05.2016, deklarata e dëshmitarit E. S. e dhënë në polici me datë 08.06.2016 si dhe në prokurori me datë 22.06.2016, deklarata e të pandehurit V.Q. e dhënë në polici me datë 18,19.05.2016 si dhe në prokurori me datë 28.10.2016, raporti i policit Nimon Rexhaj me nr. të rastit 2016-DA-0957 i datës 04.05.2016, deklarata e të dëmtuarës J. K. e dhënë në polici me datë 04.05.2016,22.06.2016 si dhe në prokurori me datë 28.10.2016, raporti i policit Ilmi Ramaj me nr. të rastit 2016-DA-1052 i datës 14.05.2016, deklarata e të dëmtuarit B. Q. e dhënë në polici me datë 14.05.2016, raporti i policit Hilmi Ramaj me nr. të rastit 2016-DA-0287 i dt. 02.02.2016, deklarata e dëshmitarit D. R. e dhënë në polici me dt.02.02.2016, raporti i policit me nr. të rastit 2016-DA-0987 i dt. 08.05.2016, deklarata e dëshmitarit A. Sh. e dhënë në polici me dt. 08.05.2016, deklarata e dëshmitarit S. B. e dhënë në polici me dt. 05.02.2015, raporti i policit Mirsad Mehoviq me nr. të rastit 2016-DA-0303 i dt. 05.02.2016, raporti i policit Tahir Kabashi me nr. të rastit 2016-DA-0383 i dt. 13.02.2016, deklarata e të dëmtuarit A. B. e dhënë në polici me dt. 13.02.2016, raporti i policit Elmira Rastoder me nr. të rastit 2016-DA-0830 i dt. 15.04.2016, deklarata e të dëshmitares F. K. e dhënë në polici me dt. 15.04.2016, deklarata e dëshmitarit Redzo Ljuca e dhënë në polici me dt.19.04.2016, raporti i policit Fikret Eroviq me nr. të rastit 2016-DA-0857 i dt. 19.04.2016, raporti i policit Nimon Rexhaj me nr. të rastit 2016-DA-0668 të dt.27.03.2016, deklarata e dëshmitarit Gzim Bacaj e dhënë në polici me dt. 27.03.2016, raporti i policit Nimon Rexhaj i datës 22.06.2016, si dhe të shikohet foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera të lënës, rrjedh se në veprimet e të pandehurit V.Q. qëndron dëshimi i bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprat penale nga pikat I, II, dhe III si në aktakuzë/aktgjykim të veprave penale të vjedhjes, parashikuar nga neni 325 par.1 të KPRK-së, dhe për veprën penale të vjedhjes së rëndë, parashikuar nga neni 327 par.1 të KPRK-së, dhe se gjykata ka gjetur dhe konstatuar se i pandehuri është përgjegjës për këto vepra penale dhe e ka dëshiruar kryerjen e tyre, duke gjetur se i njëjti ka qenë i përgjegjshëm dhe i vetëdijshëm për veprimet e ndërmarra dhe për këtë, të pandehurin e ka shpallur fajtor për veprat penale duke i përcaktuar për secilën veprë penale dënimet veç e veç, e që pas duke ja bërë unifikimin e dënimeve dhe duke e gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit me Dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe dënim i unifikuar gjore në shume prej 900 (nëntëqind) euro (me saktë si në dispozitiv të aktgjykimit).

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat mund të ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit ndaj të pandehurit, kështu si rrethanë lehtësuese ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, pati sjellje sociale dhe të paqortueshme gjatë gjykimit. Përderisa si rrethanë rënduese gjykata gjeti

se i pandehuri është i njohur për raste të tilla dhe sipas deklaramit të tij vet në procesverbal të shqyrtimit fillestar është deklaruar se ka qene me pare i dënuar për vjedhje dhe ka vuajtur dënimin me burg prej 1(nji) viti.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit, ka konsideruar se dënimi me burg i shqiptuar dhe dënimi i unifikuar me gjore janë dënime meritore dhe në harmoni me rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale që i pandehuri është akuzuar me bindjen se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit, do të parandalohet i pandehuri nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të behet rehabilitimi i tij, do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh ngritjen e moralit dhe përçimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata të dëmtuarit nga veprat penale të pikës 1,2 dhe 3 të aktgjykimit, për kërkesën pasurore juridike i ka udhëzuar në kontest civil ngase në shkresat e lendes, gjykata nuk ka gjetur kërkesa pasurore juridike të specifikuar.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest civil u morr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1, 2 pika 2.6 të KPPRK-se Gjykata ka obliguar të pandehurin që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë) euro dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 (njëzet) euro.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, gjykata e mori në përputhje me nenin 39, par.1,2,3, nën par. 3.1, të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit, duke e obliguar të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
P.nr.1057/16 më datë 16.10.2020**

**Praktikante,**

\_\_\_\_\_  
**Edita Ferati**

**Gjyqtari Gjykses,**

\_\_\_\_\_  
**Dr.sc. Murat Hulaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:029679  
Datë: 26.10.2020  
Numri i dokumentit: 01218951